verifiko.info

Udhëzues praktikë për prindër/mësimdhënës për Instagram

Udhëzuesi përdor pamje reale të aplikacionit dhe shpjegime të shkurtra poshtë tyre.



verifiko.info

Instagram: siguria dhe kontrolli prindëror

> **Këto hapa ndihmojnë në raportimin e përmbajtjes, bllokimin e kontakteve të padëshiruara, filtrimin e komenteve dhe menaxhimin e kohës.**

Për llogaritë e fëmijëve, prindi mund të përdorë edhe **Family Center / Supervision.** Aktivizimi kërkon pajtimin e prindit dhe të fëmijës.





1 Raportoni një postim ose profil

Hapi 1 Te postimi, Reel-i ose profili problematik, prekni **tri pikat** •••.

Hapi 2 Zgjidhni **Report** (Raporto).

Hapi 3 Zgjidhni arsyen që e përshkruan më mirë problemin dhe ndiqni pyetjet në ekran.

Hapi 4 Nëse ka kërcënim ose shantazh, ruani provat para raportimit.







2 Bllokoni një llogari të padëshiruar

Hapi 1 Hapni profilin e personit dhe prekni **tri pikat** •••.

Hapi 2 Zgjidhni **Block.**

Hapi 3 Nëse ofrohet, zgjidhni të bllokoni edhe llogaritë e tjera që personi mund të krijojë.

Hapi 4 Konfirmoni bllokimin. Personi nuk njoftohet se është bllokuar.

verifiko.info



3 Fshihni fjalët dhe komentet fyese

Hapi 1 Nga profili, prekni ≡ → **Settings and activity.**

Hapi 2 Hapni **Hidden Words** (Fjalët e fshehura).

Hapi 3 Aktivizoni fshehjen e komenteve dhe kërkesave për mesazhe që mund të jenë fyese.

Hapi 4 Te lista e personalizuar, shtoni fjalë, fraza ose emoji që dëshironi të filtroni.







4 Menaxhoni kohën në Instagram

Hapi 1 Nga profili, prekni ≡ → **Your activity** → **Time management.**

Hapi 2 Vendosni një kujtesë ose kufi ditor që përputhet me moshën dhe rutinën e fëmijës.

Hapi 3 Rishikoni cilësimet e njoftimeve dhe aktivizoni kujtesat për pushim. **Sleep mode** i menaxhuar nga prindi konfigurohet në Family Center, siç shpjegohet te Hapi 6.

Hapi 4 Rishikoni cilësimet së bashku pas disa ditësh dhe përshtatini kur është e nevojshme.







5 Aktivizoni Supervision në Family Center

Hapi 1 Prindi dhe fëmija duhet të kenë llogari Instagram. Fëmija duhet të jetë **13–17 vjeç,** ndërsa prindi ose kujdestari duhet të jetë mbi **18 vjeç.**

Hapi 2 Në llogarinë e prindit, shkoni te **Profile** → ≡ → **Supervision for Teen Accounts** → **Continue.**

Hapi 3 Prekni **Invite**, zgjidhni llogarinë e fëmijës ose dërgojani lidhjen e ftesës.

Hapi 4 Fëmija duhet ta hapë ftesën ndërsa është i kyçur në llogarinë e vet dhe ta pranojë mbikëqyrjen.

Hapi 5 Mbikëqyrja aktivizohet vetëm pasi të dyja palët të pajtohen. Fëmija mund të shohë se çfarë informacioni i shfaqet prindit.

6 Aktivizoni Supervision në Family Center

Hapi 1 Në **Family Center**, prekni llogarinë e adoleshentit që mbikëqyrni.

Hapi 2 Te Their teen safety settings, kontrolloni privatësinë e llogarisë, përmbajtjen sensitive dhe kush mund t'i dërgojë kërkesa për mesazhe ose ta shtojë në grupe.

Hapi 3 Te **Their connections**, mund të shihni ndjekësit, llogaritë që adoleshenti ndjek, llogaritë e bllokuara dhe emrat e llogarive me të cilat ka komunikuar së fundmi.

Hapi 4 Prindi mund të shohë **emrat e llogarive** me të cilat adoleshenti ka biseduar gjatë shtatë ditëve të fundit, por **nuk mund ta lexojë përmbajtjen e mesazheve private.**

Hapi 5 Te **Their time spent → Manage time limits**, caktoni një kufi ditor. Mund të zgjidhni që Instagrami vetëm ta kujtojë adoleshentin të dalë ose ta bllokojë përdorimin pasi të arrihet kufiri.

Hapi 6 Aktivizoni **Sleep mode**, zgjidhni ditët dhe orarin dhe vendosni nëse aplikacioni vetëm e paralajmëron apo e bllokon përdorimin gjatë atij intervali.

Për adoleshentët 13–15 vjeç, prindi mund të miratojë ose refuzojë ndryshime që do t'i bënin cilësimet e sigurisë më pak mbrojtëse.





7 Mbajeni llogarinë private

Hapi 1 Nga profili, prekni ≡ → **Settings and activity** → **Account privacy.**

Hapi 2 Aktivizoni **Private account.**

Hapi 3 Pas aktivizimit, vetëm personat e miratuar mund t'i shohin postimet dhe listën e ndjekësve.

Hapi 4 Rishikoni kërkesat për ndjekje së bashku me fëmijën dhe pranoni vetëm persona të njohur.

Hapi 5 Emri, fotografia e profilit dhe përshkrimi mund të mbeten të dukshme; mos vendosni adresë, shkollë, numër telefoni ose të dhëna të tjera personale.







8 Përdorni Limits ose Restrict kundër ngacmimit

Hapi 1 Nga **Settings and activity**, kërkoni dhe hapni **Limit interactions.** Në disa versione gjendet nën **Privacy.**

Hapi 2 Zgjidhni të kufizoni llogaritë që nuk ju ndjekin dhe ndjekësit e rinj.

Hapi 3 Caktoni kohëzgjatjen dhe prekni **Turn on.** Komentet dhe mesazhet e këtyre llogarive do të fshihen derisa t'i miratoni.

Hapi 4 Për një person të veçantë, hapni profilin e tij, prekni ••• → **Restrict**. Personi nuk njoftohet për kufizimin.

Hapi 5 Nëse ka kërcënim, shantazh ose rrezik, ruani provat dhe përdorni edhe **Report** dhe **Block.**







9 Çaktivizoni ndarjen e vendndodhjes

Hapi 1 Nga profili, prekni ☰ → **Story, live and location** → **Location sharing.** Emërtimi ose disponueshmëria e këtij opsioni mund të ndryshojë sipas versionit dhe rajonit.

Hapi 2 Te **Who can see your location,** zgjidhni **No one.**

Hapi 3 Nëse vendndodhja duhet të ndahet përkohësisht, përdorni vetëm **Close Friends** ose persona të zgjedhur dhe të besuar.

Hapi 4 Kontrolloni edhe lejen e vendndodhjes në cilësimet e telefonit dhe çaktivizojeni kur Instagrami nuk ka nevojë për të.

Hapi 5 Shpjegojini fëmijës të mos publikojë vendndodhjen e shtëpisë, shkollës ose aktivitetet e përditshme në kohë reale.

verifiko.info

Kontroll i shpejtë për llogarinë

- Mbajeni llogarinë **Private** dhe pranoni vetëm ndjekës të njohur.
- Te **Messages and story replies,** kufizoni kërkesat për mesazhe nga persona të panjohur.
- Nëse rekomandimet janë mbushur me përmbajtje të dëmshme ose dezinformuese, hapni **Profile** → ☰ → **Content preferences** → **Reset suggested content**. Ky veprim nuk mund të zhbëhet.
- Rishikoni së bashku informacionin e Family Center. Përdoreni për udhëzim dhe bisedë të hapur, jo si zëvendësim për komunikimin me fëmijën.